

Mirësevini

Integrimi është drejtimi ynë profesional

"FABIA Qendër e specializuar për këshillimin dhe integrimin e të huajve" është një shoqatë e pavarur nga ana politike dhe fetare, e cila angazhohet për integrimin e mërgimtarëve dhe mërgimtarëve. Nxitja e bashkëpunimit të vendasve dhe e të ardhurve qëndron në qendër të punës tonë.

Grupi që synojmë janë mërgimtarët/-ët me leje qëndrimi L, B dhe C dhe F (10+) si edhe zviceranët/-ët. Më tej ofertat tona i shfrytëzojnë specialistët e shërbimeve private dhe publike. Ofertat janë të përshtatshme për persona të vecantë, grupe, organizata dhe institucione publike ose private.

Fushat e veprimtarisë sonë:

Informim dhe këshillim

FABIA funksionon si **qendër e informimit dhe e këshillimit për çështjet e integrimit në fushën e mërgimit**. Ajo informon dhe këshillon personat me vendbanim në kantonin Lucern si edhe persona të specializuar, të cilët janë në kontakt me popullsinë mërgimtare në lidhje me temat që vijnë:

- Integrimi social, shoqëror dhe profesional
- Çështjet ndër- dhe transkulturore në fushën e mërgimit
- Kurse të gjuhës dhe oferta integruese
- Pyetje mbi sistemin social dhe shëndetësinë
- Pyetje mbi arsimin
- Ndërmjetësimi i specialistëve (p.sh mjek/e, terapist/e, avokat/e)
- Sqarime të së drejtës (lejet e qëndrimit, sigurimet sociale, ligjet mbi familjen etj.)

FABIA zhvillon një dokumentacion me informacione në lëmin e temave të mërgimit dhe integrimit dhe bashkëpunon për faqen e internetit www.integration-zentralschweiz.ch.

Ndihmë sociale personale

E ngarkuar nga komunat Buchrain, Ebikon, Horw, Kriens dhe Qyteti i Lucernit FABIA ofron këshillime për të huajt në kuadrin e **ndihmës sociale personale**.

Ne këshillojmë në rast problemesh personale dhe përkrahim në punët administrative.

Këshillimet bëhen në një bisedë personale ose nëpërmjet telefonit në gjuhë të ndryshme (shqip, gjermanisht, anglisht, frëngjisht, italisht, portugalisht, serbisht/kroatisht/bosnjisht, spanjisht). Në rast se nevojitet mund të porositet një përkthyes. Ne bashkëpunojmë me Shërbimin e përkthyesve të Zvicrës qendrore.

Këshillimet janë falas; për shërbimet administrative që kryhen kërkojmë një pagesë për shpenzimet.

Shkolla dhe arsimi

FABIA është e ngarkuar me detyrë nga **Shërbimi për arsimin popullor (DVS)** i kantonit të Lucernit të këshillojë mësuesit, shërbimet sociale, autoritetet shtetërore si edhe prindërit mërgimtarë për pyetjet në lidhje me integrimin dhe ecurinë e shkollës për nxënësit dhe të rinjtë jovendas. Në shkolla FABIA organizon mbledhje me prindër, organizon ndërmjetësues ndërkulturor dhe ofron përkthime me shkrim.

Nxitja e hershme

FABIA zhvillon kurse për prindërit dhe fëmijët parashkollorë në kuadrin e nxitjes së hershme. Oferta „Gjermanisht dhe informacion për nënat/baballarët dhe fëmijët“ nxit fëmijët parashkollorë qysh herët në gjuhën gjermane dhe përkrah prindërit në punën edukuese. Projekti „Më dhuro mua një tregim“ në kuadrin e Family Literacy forcon prindërit në nxitjen e hershme të fëmijëve të tyre dhe përkrah fëmijët e vegjël në përvetësimin e gjuhës.

Këshillim dhe shoqërim për projektet

Ne përkrahim organizatat dhe shoqatat në planifikimin e projekteve të integritit. Në rast se ju keni një projekt-die, ne ju këshillojmë juve në lidhje me shanset dhe vënien në zbatim, organizimin, krijimin e strukturave, mundësitë e financimit si edhe të paraqitjes së kërkesës për projektin.

Kurse dhe aktivitete

FABIA ofron kurse dhe aktivitete-impuls për temat ndërkulturore:

- Kurse gjermanishteje dhe integrimi
- Kurse për mësuesit e shkollave popullore
- Atelje për specialistët e sistemit social dhe të shëndetësisë
- Në rast se në familje fliten shumë gjuhë...
- Martesat binacionale
- Shëndeti
- Lejet e qëndrimit dhe ndikimet e tyre mbi integrimin
- Sigurimi social
- Nga shkolla në profesion
- Mania dhe mërgimi
- Dhuna në familje
- Familja vjen në Zvicër

Temat diskutohen sipas nevojës me FABIA-n. Fabia ofron module informacioni mbi tema të ndryshme për organizatat dhe shoqatat e mërgimtarëve dhe i përkrah këto organizata dhe shoqata në zhvillimin e aktiviteteve informuese.

Ndërlidhja dhe bashkëpunimi

FABIA bashkëpunon me specialistë, qendra të specializuara dhe organizata të njohura, të cilat plotësojnë punën tonë. Ne ndërmjetësojmë kontakte sipas nevojës.

FABIA përkrah dhe ndërlidh organizatat e mërgimtarëve të zonës, ndërmjetëson kontakte për të interesuarit dhe këshillon në çështjet organizative.